



IPARD II 2014 – 2020 THIRJA IV (katërt)

MASA 7 “Diversifikimi i fermave dhe Zhvillimi i Biznesit”

Ky program bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Shqiptare

1. Cilët sektorë përfshihen në financim për Masën 7 të programit IPARD-II, Thirrja IV?

- Turizmi rural dhe i Natyrës
- Punimet e artizanatit dhe industria e manufaktures

2. Cili është dokumentacioni i pronësisë i pranuar për programin?

Dokumentacioni i kërkuar për pronësinë është sipas rastit:

- Fotokopje e certifikatës së pronësisë të lëshuar nga Agjencia Shetërore e Kadastrës të shoqëruar me hartën treguese, kartela dhe planimetrin (paraqitjen) që tregon pronësinë e tokës dhe ndërtesës (ave) në të cilën do të kryhen investimet, **ose**
- Fotokopje e vërtetimit të pronësisë të lëshuar nga Agjencia Shetërore e Kadastrës të shoqëruar me hartën treguese, kartelen dhe planimetrin (paraqitjen) që tregon pronësinë e tokës dhe ndërtesës (ave) mbi të cilën do të kryhen investimet, **ose**
- Fotokopje e kontratës së transferimit të të drejtave të përdorimit (kontratë qeraje, huapërdorje) me një kohëzgjatje minimale të paktën 10 vjet pas datës së aplikimit, me vërtetim noterial (n / k për qira shtetërore) shoqëruar me
Fotokopje e vërtetimit të pronësisë të lëshuar nga Agjencia Shetërore e Kadastrës shoqëruar me hartën treguese, kartelen dhe planimetrin (paraqitjen) mbi titujt e regjistruar të tokës, ku thuhet pronësia e tokës dhe ndërtesave, personit që e ka marrë me qera.

3. Tek masa 7 a është i pranueshëm investimi për një restorant, apo duhet shoqëruar me investime të tjera dhe a duhet të jetë afër me fermën?

Në masën 7 investimi për një restorant lejohet dhe vendndodhja e tij nuk lidhet me fermën.

4. Start-ups a lejohen në IPARD?

Nuk ndalohet aplikimi i start-ups, për sa kohë që përmbushen të gjitha kërkesat dhe kriteret e programit.

5. Nëse aplikon si SHBB kush është përfituesi i investimit nga IPARD, anëtarët apo vetë SHBB?

Nëse aplikon si SHBB përfituesi është vetë SHBB, sipas aplikimit të bërë.

6. Kush janë ekspertet tek të cilët duhet të drejtohem për të bërë dokumentacionin e kërkuar?

Ekspertë të ndryshëm të sektorit privat, të cilët ofrojnë këtë shërbim. Shpenzimet për ekspertizë në përgatitje dokumentacioni janë të lejuara, sipas përcaktimeve të shpenzimeve të lejuara në Aneksin 6.

7. Nëse kemi përfituar nga skemat kombëtare a mund të aplikojmë dhe në IPARD?

Mund të aplikohet, por jo për të njëjtin investim.

8. Investimi që do të bëjmë duhet të përballohet nga investitori dhe pastaj e marrim rimbursimin?

Pas lidhjes së kontratës, investimi kryhet 100% me fondet e aplikantit, në respektim të kushteve kontraktuale, bazuar në kërkesën për pagesë, pas përfundimit të investimit bëhet pagesa e grantit.

9. Domosdoshmërisht duhen 3 oferta për realizimin e investimeve apo blerjen e pajisjeve?

Duhen domosdoshmërisht tre oferta për çdo investim të propozuar.

10. Sa aplikime lejohen brenda një mase?

Brenda së njëjtës masë lejohet vetëm një aplikim.

11. Nëse marr kredi a do të më subvencionojë AZHBR për shpenzime që lidhen me kostot bankare.

Jo, kostot bankare nuk janë shpenzime të pranueshme, sipas Aneksit 6 të programit.

12. A mund të aplikojë një shtetas i huaj, apo duhet të jetë domosdoshmërisht shtetas shqiptar?

Po një shtetas i huaj mund të aplikojë me kusht që investimi duhet të jetë në Shqipëri, dhe subjekti të jetë i regjistruar në Shqipëri.

13. Vërtetimi për pagesën e sigurimeve shoqërore për sa kohë para momentit të aplikimit nevojitet (për vitin kur bëhet aplikimi apo për 3 vitet e fundit)? Po në rastin kur fermeri është start-up?

Duhet vërtetim **Original** që provon se aplikanti ka përmbushur detyrimet e pagesës së taksave (kontributet shoqërore, shëndetësore, lëshuar nga Zyra e Tatim Taksave për personat fizikë dhe juridikë ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për fermerët individualë **jo më herët se 30 ditë përpara dorëzimit të aplikimit**. Vërtetimi duhet të dorëzohet edhe për fermerë/ persona fizikë ose juridikë të cilët janë start-up.

14. Ku mund të gjej informacion për kriteret e plotësimit të dosjes dhe udhëzuesin e aplikantëve?

Ju duhet të aksesoni në faqen zyrtare të AZHBR-së <http://www.azhbr.gov.al/ipard-ii-thirrja-e-katert> dhe <http://www.ipard.gov.al/thirrje-4/> (programet e mbështetjes, thirrja e katërt / programi IPARD-II) ku mund të shkarkoni udhëzuesin për aplikantët dhe anekset shoqëruese për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar. Gjithashtu mund të shkruani në email zyrtar: **info@azhbr.gov.al** dhe stafi jonë do t'ju kthejë përgjigje brenda afateve zyrtare.

15. Periudha e realizimit të investimit do të jetë 6 muaj, apo me shumë?

Periudha e realizimit do të jetë në varësi të investimit dhe do të përcaktohet në kontratë, sipas llojit të investimit dhe deklaramit nga aplikanti. Në prezantim është dhënë si shembull ilustrues periudha e realizimit 6 muaj.

16. A duhet të përmbush ndonjë standart që të përfitoj grant në masën 7?

Nw çdo investim në masën 7 është e detyrueshme përmbushja e standarteve minimale kombëtare në fund të investimit.

17. A mund të aplikoj për prodhim energjie të rinovueshme në masën 7 thirrjen e katërt?

Jo, investimet në sektorin e energjisë së rinovueshme nuk janë të pranueshme në thirrjen e katërt për aplikime.

18. Ku duhet dorëzuar dosja për aplikim?

Dosja fizike duhet dorëzuar në zyrat qendrore të AZHBR (**Rr. Muhamet Gjolleha Nr.56 / Tiranë**) ose me postë në të njejtën adresë; Rr. Muahmet Gjolleha Nr.56 / Tiranë, brenda **datës 25 Shkurt 2022**.